



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 523/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Florian Doberjanca me venbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hidhet i parregullt apeli i paraqitur nga Florian Doberjanca me venbanim në Gjermani, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën **18.08.2021** PZAP-i ka pranuar një apel nga **Florian Doberjanca me venbanim në Gjermani**, në të cilën pretendohet se shkak i apelit është refuzimi apo mos përmbushja e kushteve për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës pasi që nuk e ka nënshkruar aplikacionin.

Paneli, pasi që vlerësoj apelin konstaton se:

Apeli është i parregullt

Paneli, vlerësoj se ape i parashtruar ndaj vendimit të lartpërmendur është i parregullt sepse nuk i plotëson kriteret në kuptim të nenit 10.6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Nr.02/2015), andaj në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)

A nr. 523/2021 më datën 25.08.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi lejohet ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-it.